



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE
DREJTORIA JURIDIKE
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ prot.

Vlorë, më ____ . ____ .2026

PROCES VERBAL-Tipi i kontratës – e hapur Pune

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE
TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është përefekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Fondi Limit: 2,157,615.⁸³ (dymilion e njeqind e pesedhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e pesëmbëdhjetë pike tetëdhjetë e tre) Leke pa TVSH

Objekti : “ Permiresimi i kushteve te banimit per komunitetet te varfra dhe te pa favorizuar per vitin 2026

REF-97360-08-25-2026

Kodi CPV: 45210000-2 - Punime ndërtimi

E hapur e thjeshtuar Pune

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 12 muaj

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të LPP Nr. 162 datë 23.12.2020, si dhe nenin 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshime, ku mes të tjerave citohet se: *“Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”*.

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4.*

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP *“Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”*, Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale: Sipas shtojcës 8 të këtyre dokumenteve.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e kontratës.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Autoriteti Kontraktor ka konsideruar te nevojshme perfshirjen e kriterit te cituar me lart, ne mënyrë që t’i shërbejë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë pjesemarres te mundshem si dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ligjin nr.8438 date 28.12.1998 ”Per tatimin mbi te ardhurat”, i ndryshuar, neni 29.

2.2.2 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të Pushtetit Vendor për 2026 te maturaara .

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me

*originalin***Argumentimi:** Ky kriter eshte percaktuar bazuar ne ligjin nr.162/2020 date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”, neni 76 per kriteret detyruese per skualifikim.

2.2.3 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore të 3(tre) viteve të fundit (2023, 2024, 2025) të çertifikuar nga organet tatimore si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit) secili anëtar i bashkimit.

Shëmin: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: “c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e balanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1

- a. Punë të ngjashme me vlerë jo më të vogël se **30%** e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2.Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në bazë të VKM – së Nr. 42, datë 16.01.2008, i ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit :

Për punimet në ndërtim :

- **NP-1 A** Punime gjurmimi në tokë

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe VKM – së Nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit Nr. 8 402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, ku neni 8 përcakton “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj të pajisur me licencën përkatëse për zbatim punimesh ndërtimi. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në

përputhje me standartet kombëtare ose europiane. Lidhur me nivelin e kategorive në licencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomikë të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko – profesionale në nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria	Pershkrimi i kategorisë	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive
NP-1	Punime gjërmimi në tokë.	Referuar kapitullit të gërmimeve sipas parashikimit të projekt preventivit prishje/gërmime/transport/mbushje (punime për prita, gërmime shkarkimi, mbushje, transport mbeturinash). Për këtë arsye kërkohet licenca NP-1A për të garantuar që operatori ka kapacitetin teknik dhe përvojën për punime të tokës.	A

Kategoritë e mesiperme janë kërkuar referuar zerave të preventivit dhe vlerës përkatëse të cilat i përgjigjen klasifikimit të mesiperm.

2.3.3 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, CV, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për **muajin** e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

1 (një) Inxhinier Ndërtimi lejohet edhe me Kontrate Bashkëpunimi

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr.

514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Inxhinier Ndertimi** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punimeve të parashikuara në preventiv dhe kategorisë së kërkuar në licencën profesionale të shoqërisë.

Referuar natyrës dhe objektit të kontratës së prokurimit, shfaqet e nevojshme disponimi i stafit në nivel inxhinieri për realizimin e ketyre punimeve. Kriteri i mësipërm në lidhje me stafin kryesor është lidhur edhe me disponueshmërinë e licencës dhe kriterëve të licencës së kërkuar. Konkretisht në Vendimin 42, datë 16.01.2008 i Këshillit të Ministrave “*Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi*”, i ndryshuar parashikohet se: “*Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të saj të ushtrojë veprimtari të caktuar, sipas: I. Kategorive të punimeve të zbatimit duke u mbështetur në: - profilin e diplomës universitare të individëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë.*”

Sa më sipër, duke marrë parasysh natyrën e punëve të objektit të prokurimit, ka perzgjedhur stafin e drejtuesve teknik, të cilët janë të nevojshëm për realizimin e punimeve duke u buzar në natyrën e kësaj pune.

- 2.3.4** Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë **sipas neni 8, në Vendimin Nr. 448, datë 31.07.2025** “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit, dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe **jo të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës** që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:

a) Kontratë pune e vlefshme;

b) Diplomë.

Shënim: Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për të kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: *Së pari*, kjo kërkesë mbështetet ne Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”. *Së dyti*, duke qenë se objekt prokurimi është kontratë që ka të bëjë me Funizim Vendorsje sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Udhëzimi Nr.2, datë 13.05.2005 “ Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika 1.2 ku citohet se: “*drejtuesit ligjore dhe teknik te sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi*” si dhe pikës 2.1 ku citohet se “*drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejtë nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit*”

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga rendësia e objektit të kontratës, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dispozitave ligjore në fuqi.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik per kryerjen e punimeve, te vertetuar me kontratë punë te vlefshme, një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë),lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republika e Shqiperise.”, si dhe te të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, si më poshtë:

Profesioni/Kualifikimi	Numri i te punesuarve
1. Hekurkthyes	1
2. Karpentier	1
3. Specialist Catie	3
4. Elektricist	1
5. Hidraulik	1
6. Punetore te thjeshte	2

Për punonjesit manovrator/shofer, ofertuesi duhet të paraqesë:

*a) kontratë individuale të punës;
leje drejtimi, certificate e aftesimit profesional (CAP) per shoferet dhe dëshmi aftesimi profesional (DAP) per manovraret/automakinistet, që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për*

përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës. (Në rastin kur punonjësit Manovrator/shofere janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi : Kërkesat e mësipërme janë bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.6 Një punësim jo me pak se **9 (nentë)** punonjës, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi **per muajin e fundit** te deklaruar nga data e hapjes se ofertave vërtetuar me:

- a.** Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për **muajin** e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave.
- b.** Listpagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per **muajin** e fundit te deklaruar.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Gjithashtu për të vërtetuar zoterimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është duke kërkuar edhe vërtetim të leshuar nga Administrata Tatimore si dhe në listepagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr 285, datë 19.05.2021 *Per miratimin e rregullave të prokurimit publik dhe sipas të ciles: Autoriteti/enti kontraktor , pervec kerkesave te parashikuara ne kete nen, mund te percakojë kriteret e tjera te vecanta, ne varesi te objektit qe prokurohet, te cilat i vlereson te nnevojshme per ekzekutimin me sukses te kontrates.*

Shenim:Ne momentin e vleresimit dhe shqyrtimit te kriterve klasifikuese ky kriter do te konsiderohet i permbushur me dorezimin e vetdeklarimit permbledhes sipas Shtojces 8, bazuar ne nenin 82 te Ligjit Nr. 162/2020 Per prokurimin publik si dhe ne germen dh) te pikes 2 te nenit 26 te Vendimit nr.285 date 19.05.2021 te Keshillit te Ministrave Per miratimin e rregullave te prokurimit publik, i ndryshuar.

2.3.7 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:

Emri i mjetit	Sasi	Njesi	Statusi
Kamionçinë mbi 3.5 ton	1	copë	Në pronësi ose me qera
Kokore	9	copë	Në pronësi ose me qera
Kuti ndihme e shpejtë	1	copë	Në pronësi ose me qera

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës si më poshtë ;

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet:
 - a) Dokumenti që vërteton pronësinë (çertifikatën e pronësisë së mjetit rrugor);
 - b) Dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
 - c) Çertifikatën e vlefshmërisë së kontrollit teknik (SGS)
 - d) Siguracion (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
 - e) Çertifikatë transporti nga njësia vendore;
 - f) Foto të mjetit ku të dallohen qartë të dhënat specifike të tij
- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë me qira, duhet të paraqitet:
 - a) Kontrata e qerasë
 - b) Dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
 - c) Çertifikatën e vlefshmërisë së kontrollit teknik (SGS)
 - d) Siguracion (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;

e) Çertifikatë transporti nga njësia vendore;

f) Foto të mjetit ku të dallohen qartë të dhënat specifike të tij

- Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë duhet të paraqiten dokumenta që vërtetojnë pronësinë apo marrjen me qira të tyre (fatura tatimore blerje, akte ç'doganimi, kontrata noteriale për marrjen me qira)
- Për mjetet e transportit për mallrat të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqesin çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet përkatëse (e vlefshme).
- Operatori ekonomik duhet të deklarojë vendodhjen e mjeteve, me qëllim verifikimi në çdo kohë prej Autoritetit Kontraktor deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës së makinerive.
- Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar *"Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin".*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, bazuar në zërat e preventivit të punimeve.

- Mjetet e tjera që kërkohen i referohen sigurisë dhe shëndetit në kantier. Numri i kërkuar për secilin nga këto mjete i referohet numrit të personelit të kërkuar.

Numri dhe lloji i makinerive, pajisjeve në pronësi/qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i'u referuar punimeve sipas standartave, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentat konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët

ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit.

Argumentimi i specifikimeve teknike : *Specifikimet teknike jane hartuar nga specialistët e fushës, bashkëngjitur DST në SPE.*

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJËSIA PROKURIMIT